



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborní Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr. 716/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Afiete Sada-Gllogjani anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lartë Ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkritazi me ankesën e Driton Mollopolci, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Lipjan, nga radhët e subjektit politik Nisma për Kosovën (NISMA), paraqitur kundër vendimit për shpalljen e rezultateve përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me datë 08.11.2017, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 10.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e Driton Mollopolci, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Lipjan, nga radhët e subjektit politik Nisma për Kosovën (NISMA), me shenjen ZL.Anr.716/2017, të datës 09.11.2017, paraqitur kundër vendimit për shpalljen e rezultateve përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me datë 08.11.2017, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar ankesën ZL.Anr.716/2017 me datën 09.11.2017 në ora 15:15, nga parashtruesi Driton Mollopolci, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Lipjan, nga radhët e subjektit politik Nisma për Kosovën (NISMA), në të cilën pretendohet se në qendrën votimit 1309E në Brusë, është bërë bartja e votave nga numri rendor 8 tek numri 7 i po të njëjtit subjekt politik. Kërkon nga PZAP-i që të ju kthehen votat e tij.

Parashtruesi i ankesës si provë nuk ka bashkangjitur asnjë provë.

PZAP-i, pas shqyrtimit të besueshmërisë dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore si dhe shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesat janë të pabazuara

Paneli pas vlerësimit të pretendimit ankimor të ankuesit gjeti se ankuesi me asnjë provë bindëse nuk ka dëshmuar dhe nuk ka identifikuar se sa vota i mungojnë në vendvotimin në të cilin pretendon se ka pasur parregullsi. Prandaj Paneli ankesat e ankuesit i konsideron si

të përgjithësuara dhe të pa argumentuara me fakte dhe si të tilla jo bindëse pasi që nuk i plotësojnë kërkesat ligjore të përcaktuara me dispozitën e nenit 117 i Ligjit nr. 03/-073 për Zgjedhjet e Përgjithme në Republikën e Kosovës.

Rrjedhimisht PZAP-i në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse për pretendimet e paraqitura në ankesa, konstaton se ankesat në fjalë janë të pabazuara dhe e të pa argumentuara dhe si të tilla ankesat e ankuesit i refuzoj.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL.Anr.716/2017 më datën 10.11.2017.



Udhëzim Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*